- Bordi drejtues i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit (11 anëtarë) është organ ekzekutiv i kuvendit që menaxhon Kryqin e kuq midis dy seancave të Kuvendit.
- Presidenti përfaqëson organizatën brenda dhe jashtë vendit, monitoron punën e Kryqit të kuq dhe informon kuvendin, koordinon punën e organeve këshillëdhënëse të Kryqit të kuq etj. Nënkryetari ndihmon Presidentin në kryerjen e detyrave të caktuara dhe kryen detyra të tjera që i janë besuar nga Presidenti.
- Komisioni i inancave përbëhet nga presidenti dhe katër anëtarë të komisionit të zgjedhur nga Kuvendi i Kryqit të kuq.
- Sekretari i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit përfaqëson organizatën para autoriteteve kompetente, menaxhon shërbimin profesional, zbaton vendimet dhe konkluzionet e miratuara nga Kuvendi dhe Bordi Ekzekutiv
- Shërbim profesional



- Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe;
  - Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe;
  - Rrjeti rajonal i organizatave qytetare për inkluzion social të personave të moshuar;
  - Këshilli nacional për Vullnetarizmin;
  - Qendrat Rrajonale të menaxhimit të krizave;
  - Trupi koordinues për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë nacionale për persona të moshuar;
  - Sekretariati për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit të paligjshëm pranë Komisionit nacional;
  - Këshilli për siguri sociale;
  - Komiteti nacional për të Drejtën humanitare ndërkombëtare;
  - Këshilli nacional i të rinjve;
  - Mekanizmi nacional koordinues për luftën kundër tuberkulozës, malaries dhe HIV SIDA;
  - Shtabi i përgjithshëm për menaxhimin e krizave në RMV;
  - Trupi koordinues për parandalimin e varësive të qyteti të Shkupit;
  - Komisioni për të drejtat e pacientëve;
  - Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim;
  - Komisioni për gjak të sigurt;
- dhe të tjerët në nivelin nacional, si dhe anëtarësime të tjera në nivel lokal nga ana e OKKK të RM



## FUSHA TË VEPRIMIT

Departamenti për **GATISHMËRI DHE VEPRIM NDAJ FATKEQËSIVE** ka si qëllim kryesor të kontribuojë në procesin e përgatitjes së popullatës në rast të fatkeqësisë natyrore, vepron gjatë kohës së këtyre rasteve dhe merr pjesë aktive në fazën e rekonolidimit.


Në kuadër të departamentit veprojnë tre ekipe: **I Ekip për shpëtim në mal**, i cili është formë e specializuar operacionale të veprimit në terrene malore dhe të paarrtshme të përbërë nga paramedikë/alpinistë me përvojë. Përmes dy stacioneve të shpëtimit malor ata operojnë në fundjavë dhe në festat zyrtare

duke mundësuar siguri për vizitorët në vendet për piknik (duke ofruar ndihmën e parë dhe kërkimin, shpëtimin e të lënduarve nëse është e nevojshme).

**II Qendra për Siguri në ujë** është formë e specializuar veprimi në sipërfaqet e ujit. Staf i profesional i Qendrës kontribuon në uljen e rrezikut të aksidenteve të mundshme në vende për not. Fokusi i Qendrës është i ndarë në dy pjesë: trajnimi për shpëtues të rinj gjatë gjithë vitit dhe sezonin veror në të cilin shpëtimtarët janë angazhuar profesionalisht në zonat ujore.

**III Ekipi për përgjigje ndaj fatkeqësive**





(ndihma e parë dhe logjistika) i cili është i pranishëm në pjesën e sigurimit mjekësor në manifestime dhe ngjarje publike përmes distribuimit të ndihmës humanitare dhe mallrave të tjera në përputhje me Misionin e Kryqit të kuq.

**VEPRIMTARIA PARANDALUESE SHËNDETËSORE** Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit vazhdimisht vepron në përgatitjen e programeve të punës për edukim shëndetësor, monitoron realizimin e tyre dhe vlerëson rezultatet. Të gjitha aktivitetet parandaluese shëndetësore që realizon, paraprakisht i planifikon dhe koordinon, dhe përgatit material edukativ për in-

formimin publik, i cili njofton publikun me ngjarjet karakteristike aktuale në fushën e shëndetit dhe parandalimit. Me promovimin shëndetësor të sëmundje të caktuara, popullata di si të mbrohet, si t'i njohë ato dhe si të zvogëlojë rrezikun dhe pasojat e tyre.

Tradicionalisht, sipas Kalendarit, përmes aktiviteteve rregullisht shënohen:

- Java e luftës kundër sëmundjeve të enëve të zemrës
- Java e luftës kundër kancerit
- Java e luftës kundër TB
- Java e luftës kundër diabetit
- Java e luftës kundër HIV/SIDA



■ Java e kujdesit shëndetësor të dhëmbëve

Kontributin e aktiviteteve të realizuara të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit në fushën e ndihmës së parë he vepërimitarisë parandaluese shëndetësore e gëzon i gjithë komuniteti. Ndihma e parë është një veprim humanitar i disponueshëm për të gjithë, ku të gjitha njohuritë dhe aftësitë përdoren, pa diskriminim, në kohë paqeje, emergjence ose kushte luftarake ku ka të lënduar.

KKQSH ofron 3 lloje trajnimesh: Themelor, I avancuar 1 dhe I Avancuar 2,

sipas specifikave të institucionit punues. Popullsia është e gatshme të merret me situatat e përditshme kur ndodh një aksident dhe të ofrojë ndihmë të parë të të lënduarve dhe situata emergjente shëndetësore të rrezikuara jetësore. Duke pasur parasysh rëndësinë e Ndihmës së parë, janë miratuar rregulloret ligjore që detyrojnë para së gjithash kandidatët për shoferë, dhe më tej personat në organizatat punuese për ndjekjen e detyrueshme të trajnimeve dhe edukimit rreth asaj se cilat janë bazat e NP dhe si të ofrohet ndihma e parë në rast nevojë. Brenda Kryqit të kuq, ekziston Qendra



për ndihmë të parë dhe I njëjti paraqet një formë të përqendruar për edukime dhe trajnime në territorin e qytetit të Shkupit. Trajnimi nga Ndihma e parë për kandidatë për shofer është fushë prioritare, pasi vetëm njohuritë dhe aftësitë e marra siç duhet nënkuptojnë Ndihmën e parë të dhënë me kohë dhe siç duhet dhe shpëtim jete.

**DHURIMI I GJAKUT** Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, me rol koordinues ndërmjet 5 OKKK, është vazhdimisht aktiv në promovimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut në territorin e qytetit tonë. Atë promovim e realizojmë përmes 2 aksioneve të rregullta të dhurimit të gjakut (me rastin e 26 korrikut dhe 13 nëntorit), aksionet e dhurimit të gjakut të iniciuara në bashkëpunim me shoqa-

tat, fondacionet, aksionin e dhurimit të gjakut në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA në RSM në shenjë kujtimi të viktimave nga 11 shtatori, paraqitjet në media, takime të rregullta dhe takimet me komisionin e dhurimit të gjakut në organizatë, Klubin e dhuruesve të gjakut, shtypjen e materialeve promovuese dhe fletushka informative, duke motivuar popullatën e re. Në disa vitet e kaluara, përveç Klubit të dhuruesve të gjakut të KK I qytetit të Shkupit, vepron në mënyrë aktive në formë të organizuar të dhuruesve të rinj motivues të gjakut **KLUB 25**. Kjo formë e të rinjve është e

vetmja e këtij lloji në territorin e RM dhe është shembull i mirë për të motivuar popullatën e re në territorin e qytetit të Shkupit

Një hap përpara në procesin e avancimit të dhurimit të gjakut në territorin e qytetit të Shkupit paraqet edhe hapja e Qendrës së dhurimit të gjakut. Qendra ditore për dhurimit të gjakut është kryesisht një vend ku dhuruesit e mundshëm të gjakut mund të dhurojnë gjak, por në ambientet e saj kanë mundësi të shoqërohen, shkëmbejnë ide dhe përvoja, kurse dhuruesit e mundshëm të



gjakut përmes materialeve të informacionit të shtypur për qëllime të dhurimit të gjakut mund të marrin informacione të dobishme për dhurimin e gjakut.

**KKA-PVH „Kryqi i kuq në aksion-Promovimi i vlerave humane“** është program që implementohet në R. e Maqedonisë së

Veriut për 20 vjet. Paraqet mjetin nacional për tërheqjen dhe mbajtjen e vullnetarëve të rinj në Kryqin e kuq, të moshës 14 deri 18 vjeç, ose 1,200 vullnetarë të rinj në vit. Cikli KKA-PVH përbëhet nga disa aktivitete. Në fillim të çdo cikli, të rinjtë e përfshirë marrin trajnim se si të identifikojnë nevojat e komunitetit, si të zgjedhin një grup qëllimor, të vendo-

sin një qëllim dhe të bëjnë një projekt të vogël për të mirën e komunitetit. Të mbështetur nga diseminatorët e tyre, fillojnë të realizojnë projektet e tyre të vogla për të ndihmuar komunitetet lokale në të cilat jetojnë. Projektet përfshijnë të rinj me etni të ndryshme në projekte të përbashkëta për të ndërtuar mirëkuptimin e ndërsjellë, tolerancën dhe kulturën e dialogut. Disa prej tyre marrin pjesë në seminare finale në Strugë, dhe disa kalojnë punëtorinë motivuese në qytetin e tyre. Të gjithë janë të përfshirë në realizimin e javës së PVH nga 21 deri në 27 shtator. Në nivel vjetor zhvillohen 150 projekte përmes të cilave ndihmohen 3,000 njerëz, dedikohen 25,000 orë punë vullnetare dhe mblidhen mbi 30,000 euro nga komuniteti që kthehen në komunitet. Ata rinovojnë shtëpi, dhurojnë mobilje, ndërtojnë terrene lojrash, edukojnë 13-vjeçarë, dhurojnë për shërimin e fëmijëve të sëmurë, bëjnë rampa për invalid për qasje më të madhe, bëjnë karrike luhatjeje speciale për persona në karrocë, dhurojnë mjete në qendrat për persona me nevoja të veçanta dhe punojnë për të promovuar kulturat dhe paqën në vendin tonë.

**DISEMINIMI** Struktura e programit për diseminimin është pjesë themelore dhe integrale e të gjitha programeve dhe projekteve dhe ka një rëndësi të madhe për Kryqin e kuq, sepse mundëson përhapjen e historisë së origjinës së Kryqit të kuq, parimet me të cilat lëvizja udhëhiqet dhe të gjitha informacionet e rëndësishme në lidhje me aktivitetet të arrijnë tek sa më shumë qytetarë, në mënyrë që të zgjojë dëshirën për të ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë për ndihmë. Çdo vit realizohen disa punëtori me të rinjtë nga klubi i të rinjve i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, disa punëtori me personat nga mosha e tretë, disa punëtori me më të vegjlit nga kopshtet, të gjithë mbështetësit e mundshëm dhe donatorët dhe natyrisht seancat e diseminimit të organizuara për vetë punonjësit në organizatë. Brenda trajnimit të strukturuar, flitet edhe për përdorimin e drejt të stemës, respektimin e saj si dhe rregullat që vlejnë për çdo vullnetar dhe profesionist, veçanërisht deri sa mbajnë uniformën. Në nivel vjetor mbi 400 persona janë trajnuar për organizatën dhe janë të njohur me aktivitetet që janë realizuar në Kryqin e Kuq.







**INFORMIMI** dhe komunikimi me publikun dhe përcjellja e drejt e informacioneve për aktivitetet tona janë thelbësore për të kuptuar identitetin tonë dhe për të njohur misionin tonë. Përmes informacionit sigurojmë transparencë në punën tonë, dhe kështu e gjejmë vendin tonë në shoqëri më lehtë. Në këtë mënyrë kemi arritur një numër më të madh të donatorëve dhe natyrisht vullnetarëve. Mesatarisht, në baza mujore bëhen 5 paraqitje në media të ndryshme televizive ose gjithsej 60 paraqitje për promovimin e aktiviteteve, 4 herë në muaj kyçje në

radio eter ose rreth 50 transmetime në vit, 20 postime në rrjete sociale ose çdo vit rreth 250 postime. Në kuadër të këtij departamenti gjithashtu përfshihet edhe përgatitja e programit të punës, raporti mbi aktivitetet e realizuara, azhurnimin e rregullt të ueb faqes, dërgimin e informacionit të rregullt për e-gazetën, si dhe azhurnimin e të gjitha ngjarjeve në arkivin e posaçëm të Kryqit të kuq.

**TË RINJTË** Në format e veprimit të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, të rinjtë janë mbështetje, por edhe implementues



të drejtpërdrejtë të aktiviteteve programeore të projekteve. Përmes formës së organizuar të veprimit - Klubi i të rinjve, aktivitetet përqendrohen kryesisht në aktivitetet social-humanitare, shëndetësor parandalues dhe kalendarik, inicojnë dhe implementojnë aktivitete të projekteve në përputhje me vlerësimet dhe nevojat e komunitetit në të cilin jetojnë. Potenciali njerëzor - vullnetarët, si një shtyllë e organizatës, janë shtytës të aktiviteteve të shumta përmes klubit të të rinjve. Në klubin e të rinjve, 35 vullnetarë aktivë realizojnë, por gjithashtu inicojnë aktivitete në terren që ndihmojnë dhe marrin pjesë në mbështetjen

e grupeve të ndryshme qëllimore. Me qëllim të socializimit dhe shoqërimit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijët nga familjet kujdestare, është krijuar një program i veçantë për të punuar me ta. Në këtë mënyrë kontribuojmë në integrimin dhe përfshirjen e tyre më të lehtë në komunitet. Të rinjtë në mënyrë aktive përfshihen në ndihmën e komunitetit, inicojnë dhe realizojnë aktivitete dhe projekte humanitare duke bërë ndryshime pozitive në komunitet.

**VEPRIMTARIA SOCIALE HUMANITARE** në Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit është





aktivitet që arrihet përmes kategorive më të prekshme të popullsisë në territorin e qytetit të Shkupit. Ajo i përfshin të gjitha programet dhe projektet që punojnë me grupe të ndryshme qëllimore dhe përmes tyre zhvillohet. Ky aktivitet i përfshin edhe të gjithë ata persona që nuk janë përfshirë në projekt ose program dhe kanë nevojë për Kryqin e kuq. Për të gjithë këta persona funksionon Ekip për patrollim Social. Në këtë ekip punojnë punonjës socialë praktikantë të cilët këtu kanë një mundësi vendimtare për të mësuar në lidhje me punën sociale në terren, por në të njëjtën kohë të jenë mbështetja më e rëndësishme e dikujt. Punonjësit socialë janë në komunikim të vazhdueshëm me personat në rrezik që i drejtohen KKQSH për ndihmë humanitare, ose raportohen nga ndonjë institucion (institucionet e siste-

mit shtetëror, organizatat joqeveritare, etj.). Aktivitetet nënkuptojnë gjithashtu punën në terren, e cila ka të bëjë me vizitat tek personat dhe familje të rrezikuara sociale, ku bëhet një vlerësim dhe për këtë arsye vendoset se si personi/nat mund të ndihmohen. Ndihma mund të jetë në formën e ushqimit, higjienës, veshjeve, ilaçeve ose, nëse është e nevojshme, mbështetje psiko-sociale, si dhe drejtimin e personit drejt një institucioni specifik. Punonjësit socialë janë në komunikim të vazhdueshëm me shfrytëzuesit në mënyrë që të përcjellin gjendjen e tyre dhe vetë të kapërcejnë pengesat në jetë. Më shpesh, përmes këtij shërbimi ushtrohen të drejtat nga sistemi i mbrojtjes sociale dhe shëndetësore që l ofron shteti shteti për personat në rrezik.



## SHËRBIME SOCIALE

Brenda Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, nga viti 2011 implementohet një projekt kushtuar kujdesit për persona të moshuar, dmth projekti: **„QENDRA DITORE PËR PERSONA TË MOSHUAR DHE QENDRA PËR OFRIMIN E NDIHMËS NË KUSHTE SHTËPIAKE“**. Projekti është zhvilluar dhe implementuar me qëllimin themelor të zhvillimit të formave të mbrojtjes jo-institucional dhe sigurimin e kujdesit dhe mbrojtjes shëndetësore të personave të moshuar dhe të sëmurët. Qëllimet specifike të projektit janë: Avansimi i cilësisë së jetës, shëndetit dhe gjendjes psiko-fizike të personave të moshuar; Plotësimi i nevojave shëndetësore dhe sociale të të personave të moshuar; Socializimi dhe pasurimi i nivelit të arsimit të personave të moshuar; Promovimi i një qasjeje aktive ndaj jetës në pleqëri dhe Promovimi i vullnetarizmit, përfshirja e qytetarëve në punë vullnetare. Grupi qëllimor i projektit janë

personat e moshuar dhe të dobët që jetojnë vetëm ose me bashkëshortin e tyre që kanë nevojë për mbështetje mjekësore dhe psiko-sociale. Çdo person i moshuar vizitohet në shtëpinë e tyre nga një infermiere dhe një vullnetar një herë në javë, dhe nëse është e nevojshme edhe më shpesh. Në projektin për nevojat e personave të moshuar janë përfshirë vullnetarë dhe infermierë. Shërbimet që i ofron personi mjekësor janë: matja e sheqerit në gjak, matja e presionit të gjakut, kontaktet me mjekun amë, shpërndarja e ilaçeve falas (të parashikuara në projekt), dhënia e këshillave për marrjen e terapisë, dhënia e këshillave dietike dhe shoqërimi i personit të moshuar gjatë shkuarjes te mjeku.

Shërbimet e ofruara nga vullnetarët janë: biseda dhe aktivitete të tjera për socializim, ndarjen e ushqimit, ndihmën në blerjen e ushqimit, ilaçeve, etj., Shoqërimi dhe personit të moshuar kur shkon te



mjeku, në shëtitje, etj., Kryerja e punëve administrative për personin e moshuar.

Për personat e moshuar aktiv brenda projektit funksionojnë 3 qendra ditore për prona të moshuaredhe atë në hapësirat e Shtëpise të Organizatave Humanitare Dare Xhambaz, në hapësirat e Kryqit të kuq Çair dhe shkolla fillore Dituria në Saraj. Këtu, këta persona janë të përfshirë në aktivitete programore për plakje aktive, si dhe parandalimin e shëndetit dhe kujdesin social.

**QENDRA E KUJDESIT** është shërbim për kujdesin në shtëpi dhe kujdesin për persona të moshuar dhe të dobët nga kujdestarë të çertifikuar dhe profesionistë, për këdo që nuk është në gjendje të kujdeset dhe të funksionojë në mënyrë të pavarur, por nuk dëshiron të vendoset në institucion, por dëshiron kujdesin ta merr në komoditetin e shtëpisë së tyre. Brenda kësaj qendre, realizohen dy qëllime themelore:

- Sigurimi i shërbimeve në kushte shtëpiake të dedikuara për persona të moshuar dhe të dobët nga kujdestarët e çertifikuar në territorin e qytetit të Shkupit;
- trajnim dhe certifikim i kujdestarëve të rinj brenda qendrës së trajnimit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Qendra e Kujdesit vazhdimisht punon në ngritjen e vetëdijes për nevojën për kujdes profesional dhe cilësor në shtëpi, i cili do të sigurohet nga kujdestarë të çertifikuar dhe vazhdimisht punon në ngritjen e kapaciteteve të kujdestarëve që punojnë në terren përmes trajnimeve, punëtorive, takimeve për shkëmbimin e përvojave dhe vizitave studimore. Gama e gjerë e shërbimeve të kujdesit përfshin shërbime themelore dhe shtesë, dhe për secilin shfrytëzues përgatitet pako e veçantë e shërbimeve në varësi të kërkesave dhe nevojave individuale. Pas vlerësimit të ekipit dhe në marrëveshje me shfrytëzuesin, caktohet një kujdestar







adekuat, i cili prezantohet më parë në një takim shtesë.

Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit si rezultat i shumë viteve të punës në fushën e dhurimit të veshjeve dhe shpërndarjes së tyre tek më të rrezikuarit, zhvilloi projektin **KOPÇE**. Qytetarët marrin pjesë aktive në procesin e dhurimit përmes dhurimeve individuale, por edhe përmes aksioneve të organizuara në ndërmarrjet e tyre, institucione apo organizata. Pas procesit të përzgjedhjes, një pjesë e ruajtur mirë shpërndahet falas tek kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve, dhe një pjesë shitet me çmime të ulëta dhe u dedikohet njerëzve me të ardhura të ulëta dhe për të gjithë qytetarët e tjerë. Rrobat që nuk mund të vishen kanë për qëllim ripërdorimin dhe prodhimin e produkteve të reja. Në Kopçe tashmë punojnë persona nga kategoritë e rrezikuara të cilët viteve të kaluara kanë kaluar nëpër një sërë trajnimesh në Kryqin e kuq. Aktualisht në procesin e riintegritimit të punës janë të përfshirë persona përmes tra-

jnimit për qepje, por edhe njerëz me kontribut vullnetar. Me këtë mënyrë të punës mundësojmë krijimin e shpërbimeve për dhurimi të përgjegjshëm dhe shpenzime të përgjegjshme, trajnim dhe punësim të personave të rrezikuar dhe mbrojtjen e mjedisit duke ripërdorur veshje të tepërta.

Dyqani ndodhet në qendër të qytetit në ndërtesën e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**ASISTENTË TË GRUPEVE TË RREZIKUARA QËLLIMORE** Shërbimi social „Asistentë të grupeve të rrezikuara qëllimore“ pranë Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit është shërbim i dedikuar për të mbështetur, ndihmuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës së personave me kufizime dhe është i hapur çdo ditë nga ora 08:00 deri në 16:00, dhe gjindet në hapësirat e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i këtij shërbimi social është të përmirësojë cilësinë e jetës së

tyre me ndihmën dhe mbështetjen që shfrytëzuesit marrin nga asistenti ose vullnetari, duke arritur pavarësi më të madhe, si dhe funksionim më të lehtë indirekt jo vetëm të shfrytëzuesve por edhe të tyre anëtarët e familjes. Lloji i parë i mbështetjes që u ofrohet përdoruesve në baza ditore është përdorimi i një shërbimi ndihmës. Roli i moderatorit është të përfshihet në planifikimin dhe ofrimin e shërbimit ndaj klientit, të tilla si ndihma dhe mbështetja në shtëpinë e klientit, vendi i punës ose procesi arsimor, dhe ndihma dhe mbështetja në komunitetin në të cilin ata jetojnë. Lloji i dytë i mbështetjes që u ofrohet përdoruesve në baza javore është përdorimi i një shërbimi vullnetar. Roli i vullnetarit është të përmirësojë procesin e socializimit të këtyre njerëzve, ndihmën në shtëpi, prokurimin, shoqërimin te një mjek i familjes, mbështetjen administrative në institucione të ndryshme, shëtitjet e përbashkëta, lojërat sociale, etj. Shërbimi shoqëror „Ndhimësit e grupeve

të cënueshme të përdoruesve“ zbatohet nga Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit me mbështetjen e Qytetit të Shkupit.

Programi për **ASISTENCË PERSONALE PËR PERSONAT ME KUFIZIME** иsynon të përmirësojë sistemin, shërbimet dhe kapacitetet profesionale për përfshirjen sociale të burrave dhe grave që janë në gjendje fizike më pak të favorshëm dhe të promovojë mundësi të barabarta në tregun e punës. Asistenca personale duhet të ndihmojë personin me kufizime për të arritur pavarësi më të madhe dhe për të përbushur plotësisht të drejtat e tij. Ajo bazohet gjithashtu në faktin se personat me kufizime duhet të kenë të njëjtat të drejta si të gjithë të tjerët dhe duhet të jenë në gjendje të zgjedhin lirshëm dhe të menaxhojnë jetën e tyre personale në mënyrë të pavarur. Asistenti personal siguron ndihmë dhe mbështetje në shtëpinë e shfrytëzuesit, vendin e



punës, arsimin e lartë, arsimin joformal ose rehabilitimin profesional dhe në komunitetin në të cilin jeton përfituesi. Programi i trajnimit për asistent personal është zhvilluar nga Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është verifikuar nga Qendra për Arsimin e të Rriturve. Asistentët personalë trajnohen për një periudhë prej dy muajsh dhe pas përfundimit të tyre asistentët marrin një provim përfundimtar para një komisioni profesional për verifikimin e njohurive të marra dhe marrin një certifikatë të njohur nga shteti nëse kalojnë me sukses provimin përfundimtar. Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit ka rolin e ofruesit të shërbimit të ndihmës personale.

Pas përfundimit të trajnimit, shfrytëzuesit lidhen me asistentët e duhur personalë të çertifikuar, ku lidhin marrëveshje

me Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit. Gjatë gjithë procesit të përdorimit dhe ofrimit të shërbimit, bëhet monitorim, vlerësim dhe rregullisht përillet cilësia e shërbimit të ofruar.

**PUNKTI PËR TË PASTREHË** në Momin Potok u hap në vitin 2008, ndërsa pjesa Stacionare-Strehimorja u hap në vitin 2010, që do të thotë se strehimorja është në funksion për më shumë se 10 vjet dhe është e hapur gjatë gjithë vitit. Për të dhjetin vit radhazi, punkti për të pastrehë në Momin Potok është i vetmi vend ku personat e pastrehë marrin shërbime nga mjeku, punonjës social dhe psikolog, si dhe shërbime higjienike dhe berberësh. Punkti për të pastrehët është i hapur çdo ditë pune për konsultë, ndërsa larja, ndërimi i rrobave të pista, marrja e një vakti







të nxehtë, marrja e ilaçeve, ekzaminimet e mjekut dhe marrja e dokumentacionit personal dhe një sërë aktivitetesh të tjera realizohen dy herë në javë, ku në baza ditore 60 persona të pastrehë shërbehen. Mesatarisht, 60 të pastrehë marrin shërbime çdo të premte nga ekipi profesional, nga të cilët 15 të pastrehë janë riintegruar në rrjedha të shëndetshme shoqërore. Në punktin për të pastrehë gjatë temperaturave ekstreme të ulëta, funksionon edhe strehimorja e përkohshme për të pastrehë të Kryqit të kuq, vend që është i gatshëm në çdo kohë për të pritur person të pastrehë që është në gjendje të rëndë shëndetësore dhe për të cilin nuk ka zgjidhje të menjëhershme për akomodim në një institucion të përshtatshëm. Gjithashtu për periudhën e dimrit, përgatitet Plan për veprim në temperatura jashtëzakonisht të ulëta, brenda të cilit është planifikuar të hapet Strehimorja dhe kujdestari 24-orëshe të ekipeve të Kryqit të kuq dhe automjet që

operon në terren. Kapaciteti akomodues i strehimores është 32 shtretër, por nëse paraqitet një numër më i madh i personave të pastrehë për kujdes, kjo hapësirë përshtatet dhe mund të strehojë deri në 40 të pastrehë.

### ***PROGRAMI PËR NDIHMN E MIGRANTËVE /REFUGJATËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË***

ÇKryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit përmes ekipeve lëvizëse në terren ofron mbështetje me ndihmë mjekësore dhe humanitare për migrantët dhe refugjatët në Qendrat e Përkohshme transitore për refugjatë/migrantë në Tabanoc (Kumanovo) dhe Vinojug (Gjevgjeli), migrantë të parregullt në Llojan dhe Vaksincë dhe Qendrën e Pritjes për të Huaj - Gazi Babë, si dhe uljen e rrezikshmërisë së foshnjave, fëmijëve, nënave, personave të moshuar dhe personave me nevoja të veçanta. Veprimë edhe në drejtim të forcimit dhe koordinimit të aktiviteve të bashku me

të gjitha organizatat e përfshira qeveritare dhe joqeveritare që punojnë në terren. Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit është i pranishëm në terren 24 orë në ditë në qendrat në Vinojug, Tabanoc dhe Llojane/ Vaksincë me ekipet nga ndihma e parë dhe ekipet e mbështetjes logjistike. Ekipi që është angazhuar në terren është i përbërë nga një ekip mjekësor, një ekip logjistikë, një ekip për shpërndarje dhe një ekip i kërkesave të shërbimit. Ekipi Mobil Likovë pranë Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit në bashkëpunim me donatorët dhe partnerët, me implementimin e projektit për ndihmë humanitare për migrimin e parregullt përgjatë brezit të gjelbër në kufirin verior të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ekipi mobil në përputhje me qëllimet e përcaktuara, përveç

qasjes humanitare ndaj migrantëve, përpiqet të ndërtojë besim me popullatën lokale, duke hapur klube të rinjve në shkolla fillore në disa fshatra në Komunën e Likovës, duke mbajtur punëtori në bashkëpunim me Policinë Kufitare, duke rritur ndërgjegjësimin për praninë e migrantëve, si dhe duke ndihmuar familjet e rrezikuara sociale në komunë në formën e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore. Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme në Qendrën e Pritjes për të Huaj - Gazi Babë, Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit ofron kujdes shëndetësor parësor, triagji të migrantëve në qendër dhe ndërmjetësim në nivelin sekondar dhe terciar. Ilaçet e nevojshme sigurohen çdo javë dhe ndihma humanitare në ushqime dhe produkte jo-ushqimore.





## AKTIVITETET E KRYQIT TË KUQ TË QYTETIT TË SHKUPIT NË SITUATËN E JASHTËZAKONSHME ME KOVID 19 (KORONAVIRUS)

Kryqi i kuq është organizatë që siguroi mbështetje në trajtimin e Koronavirusit që në momentet e para kur u identifikua në vendin tonë. Aktivitetet u koordinuan me Ministrinë e Shëndetësisë të RMV, Qendrën për Menaxhimin e Krizave, vetëqeverisjen lokale si dhe organizatat dhe institucionet në nivelin lokal dhe

nacional. KKRMMV- Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit është anëtar i Shtabit të Krizave në nivel nacional për ballafaqimin me situatën me KOVID-19 dhe kontribuon plotësisht në aktivitetet për tejkalimin e situatës. Aktivitetet u përqendruan kryesisht në mobilizimin e kapacitetit vullnetar 24 të organizatës, formimin e ekipeve lëvizëse që



bëjnë furnizimin me artikuj ushqimorë, ilaçeve dhe pajisjeve higjienike në mënyrë që të mbështesin popullatën më të prekshme - të moshuarit, tpersonat e brishtë që jetojnë vetëm, të sëmurët kronikë, deri te familjet me persona me nevoja të veçanta, prindërve të vetëm dhe kategorive të tjera të rrezikuara të qytetarëve. Depot dhe automjetet në dispozicion të organizatës u vunë gjithashtu në dispozicion në mënyrë që të organizonin ndihma humanitare në të gjitha pjesët e vendit. Aktivitetet u koordinuan në përputhje me rekomandimet e Qeverisë së RMV, ekipet e Kryqit të kuq ishin mbështetje logjistike në shumë operacione, dhe u organizuan disa organizata që përmes Kryqit të kuq ofruan donacione si përparësi, aty ku ishte më e nevojshme.

KKRMV- Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, si organizata më e madhe në territorin e RMV, mbulon territorin dhe numrin më të madh të banorëve dhe ishte i pari që doli në terren dhe krijoi dhe zbatoi një sërë aktivitete për të lehtësimin e situatës së popullsisë.

Kjo nënkuptonte:

- “Mobilizimin e fondeve nga sektori i korporatave të dedikuara për furnizimin e materialeve të mbrojtjes mjekësore (maska, doreza dhe pajisje të tjera mbrojtëse) dhe shpërndarjen e tyre për nevojat e ekipeve lëvizëse në terren, si dhe për kategoritë e rrezikuara të shfrytëzuesve;
- Furnizimi me pajisje higjienike dhe distribuimi i tyre në disa institucione që strehojnë fëmijë dhe të rinj;
- Furnizimi dhe distribuimi i pakove ushqimore dhe higjienike që ju shpërndanë kategorive më të rrezikuara të cilët për shkak të situatës së përgjithshme u bënë edhe më të rrezikuar Formimi i ekipeve lëvizëse të përbërë nga vullnetarë që shpërndanë ndihma humanitare.
- Mbështetje për personat në izolim dhe vetë-izolim me shpërndarjen e ushqimeve dhe pajisjeve të nevojshme higjienike
- Furnizimi me ilaçe dhe terapi onkologjike për persona në izolim dhe vetëizolim
- Ndihma për personat e pastrehë si një nga kategoritë më të rrezikuara, shtimi i fushës së aktiviteteve në Punktin e të pastrehëve të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe strehimoren Hapja e linjës SOS për mbështetje psikosociale të qytetarëve - e gjithë popullsia dhe linja SOS për persona të moshuar dhe të brishtë
- Shtypja dhe shpërndarja e fletushkave për qytetarët me këshilla për mbrojtje nga KOVID-19, si dhe këshilla për mbështetje psiko-sociale.

## **RISHIKIMI I PROJEKTEVE TË REALIZUARA NË KRYQIN E KUQ TË QYTETIT TË SHKUPIT PËR PERIUdhËN (2014-2019)**

<b>Donator</b>	<b>Titulli i projektit</b>	<b>Periudha e implementimit</b>	<b>QËllimi i projektit</b>	<b>Granti gjithsej (shprehur në MKD)</b>
<b>Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)</b>	Ndihma shëndetësore dhe ndihmë logjistike për refugjatët në Maqedoni	2005 – në rrjedhje	Ndihma shëndetësore dhe ndihmë logjistike për refugjatët në Maqedoni si dhe ndihmë dhe mbështetje për migrantët	<b>Viti 2014 15.750.000</b> <b>Viti 2015 1.404.890,38</b> <b>Viti 2016 1.172.103,13</b> <b>Viti 2017 464.796,03</b> <b>Viti 2018 14.319.280</b> <b>Viti 2019 11 350 662</b> <b>Viti 2020 17.701.648</b>
	Punkti për të pastrehë	2008- në rrjedhje	Reduktimi i rrezikshmërisë së të pastrehëve në Shkup	<b>1.700.000</b> <i>(në nivel vjetor)</i>  <b>Viti 2019 – 1.500 000</b> <i>(për avansim të kapaciteteve)</i>
	Stacioni i shpëtues malor Vodno dhe Matka dhe Programi për mbrojtjen nga fatkeqësitë	2009-në rrjedhje	Kujdes dhe siguri për vizitorët në Vodno dhe Matkë Kontributi në uljen e rrezikshmërisë së popullatës në rast të fatkeqësive natyrore (vala e nxehtësisë)	<b>420 000,00</b> <i>(në nivel vjetor)</i>  <b>500 000,00</b> <i>(në nivel vjetor)</i>
<b>Qyteti i Shkupit, Alkaloid, Sava sigurimi, NLB fondi i ri pensional, Promes, Specijal, Teteks</b>				
<b>Qyteti i Shkupit, Albiz, EVN, Sparkasse Bank, Ambasada Sllovake, Kryqi i kuq Austriak</b>	Qendra ditore për persona të moshuar dhe qendra për ofrimin e ndihmës në kushte shtëpiake	2012-në rrjedhje	Sigurimi i kujdesit, kujdesit shoqëror dhe shëndetësor për persona të moshuar dhe të brishtë duke zhvilluar forma të kujdesit jashtë-institucional	<b>Viti 2014 1.625 000</b> <b>Viti 2015 1.222 899</b> <b>Viti 2016 3.116 465</b> <b>Viti 2017 2.780 504</b> <b>Viti 2018 2.300 000</b> <b>Viti 2019 2.800 000</b>

<b>Alfa Bank, fonde veta- nake, individë, kompani LDS Charities HORUS</b>	<p>Punkt për rroba- Kopçe</p> <p>Punëtori për in- tegrimin në punë të kategorisë së rrezikuar të qytetarëve Kopçe Përfshirja e shtu- ar sociale e grave në rrezik social</p>	<p>2014 - në rrjedhojë</p>	<p>Plotësimi i nevojave për rroba për kate- goritë e rrezikuara sociale Trajnim për pëlhurë për kategori të rrezi- kuara dhe përgatitja e çarçafëve për dhurim në shtëpi në grupe të vogla Trajnim për pëlhurë për kategori të rrezi- kuara dhe përgatitja e aksesorëve për shitje në Kopçe Plotësimi i nevojës për rroba për kate- goritë e cenueshme shoqërore</p>	<p><b>Viti 2014 492 800</b></p> <p><b>Viti 2018 142 375</b></p> <p><b>Viti 2019 290 000</b></p>
	<p>Hapja e një Qendre Ditore për dhurimin e gjakut</p>	<p>2014</p>	<p>Kontribut në furnizimin me gjak dhe produkte të gjakut të nevojshme për qendrat klinike, ndihmë për të gjithë ata që kanë nevojë për gjak dhe produkte të gjakut</p>	<p><b>240 000</b></p>
	<p>Qendra ditore për dhurimin e gjakut</p> <p>Qëllimi i mjeteve për piknik humanitar</p>	<p>Prill 2014- në rrjedhojë</p> <p>2015</p>	<p>Vazhdimësia në furnizimin me gjak dhe produkte të gjakut të nevojshme për qendrat klinike, ndihmë për të gjithë ata që kanë nevojë për gjak dhe produkte të gjakut</p>	<p><b>600 000 në nivel vjetor</b></p> <p><b>750 000</b></p>
<p><b>Alkaloid sh.a. Shkup</b></p>	<p>Trajnim infirmieror për persona të moshuar dhe të brishtë</p>	<p>2018</p>	<p>Mbështetje për aktivitetet e KK për zbutjen e nevojave të migrantëve</p> <p>Trajnimi i 15 personave për të punuar me persona të moshuar dhe të brishtë dhe marrja e çertifikates</p>	<p><b>272 000</b></p>



<b>KK Zvicerian</b>	Qendra e Kujdesit për persona të moshuar dhe të brishtë	2018	Zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të Qendrës së Kujdesit	<b>541 200</b>
<b>KK austriak, qyteti i Vjenës</b>	Qendra për kujdes dhe trajnim	2018 -	Sigurimi i trajnimit për kujdestarë të rinj dhe forcimi i kapaciteteve të shërbimit profesional dhe vullnetarëve të KK përmes trajnimeve për plakje të shëndetshme	<b>2.049 979,00</b>
<b>Qytetii i Shkupit</b>	Klube shkollore për edukim dhe parandalim të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit	Viti 2017 dhe 2018	Forcimi i kapaciteteve të të rinjve në 10 shkolla të mesme në territorin e qytetit të Shkupit dhe ofrimi i ndihmës për komunitetin	<b>300 000</b>
<b>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</b>	Riintegrimi i njerëzve të pastrehë të vendosur në Qendra për të pastrehë- fshati Çiçino	09/2017 – 12/2017	Përmirësimi i situatës dhe mundësive për ri-integrim të personave të pastrehë	<b>329.980</b>
<b>UNICEF</b>	Mbështetja e vendit për t'iu përgjigjurn-daj krizës së migrantëve	2015 - 2017	Reduktimi i rrezikshmërisë së fëmijëve dhe nënave migrante	<b>2.960.000</b>
<b>Save the children - Maqedoni</b>	Mbështetja ndaj migrantëve të parregullt	2015 - 2017	Reduktimi i rrezikshmërisë së fëmijëve dhe nënave migrante	<b>730.000</b>
<b>Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe</b>	"Klubi i Edukimit dhe Parandalimit në Shuto Orizarë, PD Approach Shembull pozitiv në komunitet	2017-2018	Zbatimi i metodës së Shembullit Pozitiv që do të identifikojë sjelljet e nxënësve romë në ShMQSh Shaip Jusuf , Shuto Orizarë, Shkup", dhe kështu do t'iu mundësojë atyre që të kenë rezultate më të mira në shkollë dhe një nivel më të lartë	<b>460.000</b>

<p><b>Universiteti i Evropës Juglindore dhe Lidhja Nationale e të Verbërve të Republikës së Maqedonisë. Financuar nga USAID, në kuadër të projektit "US-AID dhe LCIF për fëmijë me kufizime në të pamurit"</b></p>	<p>„Qendra për mbështetje të personave me shikim të dëmtuar“</p>	<p>2016-në rrjedhojë</p>	<p>Përmirësimi i cilësisë së jetës së tyre me punëtori edukative, këshillim psikologjik për personat me shikim të dëmtuar dhe familjet e tyre, procesi i socializimit, mbështetja administrative për realizimin e të drejtave të tyre, , preventim shëndetësor dhe ngritja e ndërgjegjes dh elobim për nevojat e personave me shikim të dëmtuar</p>	<p><b>1.740.000</b></p>
<p><b>2014 CIR-a 2015 Ambasadë Amerikane në Republikën e Maqedonisë 2016 CIVIKA mobilitas 2017 viti: IFRC, KKR MV 2014 CIR mobilitas 2017: IFRC dhe MKK</b></p>	<p>Kryqi i kuq në aksion-Promovimi i vlerave humane KKA-PVH</p>		<p>Promovimi i kulturës së dialogut, si bazë për një shoqëri ndërkulturore, duke promovuar vlerat e KK dhe duke promovuar njohuri aktive dhe si bazë për një qasje aktive ndaj jetës</p>	<p><b>Viti 2014 1.230 000 Viti 2015 1.107 000 Viti 2016 1.540.000 Viti 2017 1.230.000</b></p>
<p><b>„Transmet“</b></p>	<p>Klube shkollore për edukim dhe parandalim të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit</p>	<p>2016</p>	<p>Forcimi i kapaciteteve të të rinjve në 22 shkolla të mesme dhe fillore në territorin e qytetit të Shkupit dhe ofrimi i ndihmës për komunitetin</p>	<p><b>600.000</b></p>
<p><b>BE, Fondacioni Divac - Serbi, Komiteti i Helsinkit Shkup, Qendra Humanitare e Novi Sadit, "ARBEITER - SAMARITER - BUND"</b></p>	<p>Ndihma psiko sociale e mi-grantëve</p>	<p>Qershor 2017-dhjetor 2018</p>	<p>Forcimi i kapaciteteve të subjekteve përkatëse për reagimin fillestar ndaj katastrofave dhe krizave të migrantëve</p>	<p><b>960.000</b></p>

<b>BE-ja në bashkëpunim me Konrad Adenauer, kurse në implementimin e Shoqatës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë dhe OJQ Atina nga R. e Serbisë</b>	„Krijojmë sëbashku- Monitorimi dhe përfaqësimi i komunitetit“	2018	Ngritja e ndërgjegjësimit të publikut tek autoritetet lokale, komunitetit, të rinjve në shkolla për nocionin migrime/migrant dhe arsyet e migrimit	<b>300.000</b>
<b>MCMC (programi i mbështetur nga Bashkimi Evropian)</b>	Me më shumë transparencë deri tek ndikimi më i madh	2018-2019	Kontribut drejt përforcimit të kapaciteteve të organizatave qytetare për transparencë dhe llogaridhënie ndaj partnerëve, donatorëve dhe publikut	<b>455 600</b>
<b>Pivara A.sh Shkup</b>	Mbështetje për ekipet mobile	2020	Përballimi me Covid -19	<b>368.700</b>
<b>Lotaria shtetërore</b>	Mbështetje për persona të moshës së tretë	2020	Përballimi me Covid -19	<b>900.000</b>
<b>Fondacioni i Shoqërisë së Hapur</b>	Mbështetje për popullatën e rrezikuar rome	2020	Përballimi me Covid -19	<b>14.330.000</b>
<b>Fondacioni Coca Cola</b>	Mbështetje për ekipet lëvizëse dhe popullatën e rrezikuar	2020	Përballimi me Covid -19	<b>5.630.000</b>
<b>Kryqi I kuq Zvicerian</b>	Mbështetje për ekipet lëvizëse dhe popullatën e rrezikuar	2020	Përballimi me Covid -19	<b>2.000.000</b>
<b>Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme</b>	Mbështetje për migrantët	2020	Përballimi me Covid -19	<b>491.600</b>
<b>UNICEF</b>	Mbështetje për popullatën e rrezikuar	2020	Përballimi me Covid -19	<b>6.555.600</b>
<b>Tobako Imperial</b>	Mbështetje për popullatën e rrezikuar	2020	Përballimi me Covid -19	<b>1.000.000</b>
<b>Sparkasse banka</b>	Mbështetje për popullatën e rrezikuar	2020	Përballimi me Covid -19	<b>900.000</b>
<b>484 përmes ambasadës norvegjeze</b>	Mbështetje për migrantët	2020	Përballimi me Covid -19	<b>1.842.000</b>
<b>Qyteti i Shkupit</b>	Mbështetje për popullatën e rrezikuar përmes programeve dhe shërbimeve	2020	Mbështetje për aktivitetet programore dhe të projekteve	<b>12.663.968</b>
<b>Alkaloid</b>	Qendra për Mbështetje për të pastrehët dhe Qendra për dhurimin e gjakut	2020	Mbështetje për aktivitetet programore dhe të projekteve	<b>572.688</b>







## **BASIC INFORMATION ABOUT THE RED CROSS OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA CITY RED CROSS OF SKOPJE**

The City Red Cross of Skopje (CRCS) was founded in 1945 and it is part of the National Society of the Red Cross of the Republic of Macedonia and thus part of the International Movement of the Red Cross and the Red Crescent. The CRCS has a coordinating role over the Red Cross branches of the City of Skopje. The CRCS is a voluntary, massive, independent humanitarian organization of the citizens of the city of Skopje who acts and works as a non-governmental and non-partisan organization and in accordance with the positive regulations of the state, the RC Law of the Republic of Macedonia, the Statute of the RC of the Republic of Macedonia and its own statute.

The membership of the Red Cross in a number of international and coordinative bodies enables it to participate in the preparation of activity-related strategies. The City Red Cross of Skopje works closely with a large number of governmental and non-governmental organizations, as well as with the business sector. The business sector members are usually included as donors, but also as partners in the implementation of programs and projects aimed at helping and supporting the vulnerable population.

Area/s of action according to the Statute:

The City RC of Skopje is active in the following areas:


- Socio humanitarian activities;
- Health prevention;
- Blood donation,
- First Aid;
- Disaster preparedness and response;
- Dissemination and PHV;
- International cooperation;
- Youth;
- Information.

**Mission:** The Red Cross of the Republic of Macedonia - Red Cross of the City of Skopje is a humanitarian organization that works on prevention and alleviation of human suffering, protection of life and health, improvement of the social condition, ensuring respect and dignity for the human being especially in the case of accidents and disasters; it promotes international humanitarian law and human values, encourages voluntary engagement and constant preparedness for providing help, as well as a universal sense of solidarity and humanity.



**Vision:** We act, encourage and promote human values in order to respond to the contemporary humanitarian challenges in a timely manner, while at the same time being determined to do more, to do it better and to get farther.

 Црвен крст на Република Северна Македонија  
 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut  
 ШТАБ НА СТРУГА, ШТАБ НА ШТИП, ШТАБ НА ТИВАРЕВО







## RESOURCES

The City Red Cross of Skopje has its own office space of 250m<sup>2</sup>, 318m<sup>2</sup> warehouse in Momin Potok and 400 m<sup>2</sup> warehouse in Vodno. The City Red Cross of Skopje also owns the training center Solferino in Struga which has 10000 m<sup>2</sup>. The organization has 7 light vehicles, 2 freight vehicles, 2 passenger vans and other technical equipment. The First-aid cabinets, the cabinets for training of the carers for old and disabled people and personal assistants, the Daily blood donation center, the Daily center for visually impaired persons, the Point and Shelter for homeless persons are all equipped in accordance with their specific needs. The main carriers of our work are the volunteers. We are present in the community and in doing so we promote the ideals of the movement that are recognizable around the world. We also share our mutual values with the beneficiaries of the services, the partner organizations and the authorities.



## MANAGEMENT AND EXECUTIVE STRUCTURE

- Assembly of the City Red Cross of Skopje is the highest governing body of the organization composed of 27 members
- The Executive board of the City Red Cross of Skopje (11 members) is an executive body of the Assembly that manages the Red Cross between the two sessions of the Assembly.
